

# Kartela e çdo pacienti me SPOK duhet të ketë:

## Parandalimi i SPOK:

1. Kartela e çdo pacienti duhanpirës ka të dokumentuar sa paketë-vite\*ka konsumuar.
2. Kartela e çdo pacienti që ka mbi 10 paketë-vite ka të dokumentuar që:
  - i) është përfshirë në edukimin motivues mbi lënien e duhanit për parandalimin e zhvillimit të SPOK-ut dhe
  - ii) ka të plotësuar si pjesë të kartelës pyetësorin përdepistimin për SPOK

## Menaxhimi i SPOK:

1. Kartela e çdo pacienti me SPOK ka të dokumentuar në faqen kryesore dhe të përditësuar në çdo vizitë, sipas rastit, të dhënat si më poshtë:

- Alergjitë
- Medikamentet që merr
- Sëmundjet shoqëruese dhe nëse janë apo jo të kontrolluara
- Duhan paketa-vite
- Profesion/Ambienti i punës
- Vaksinimi kundrejt pneumokokut, gripit (përfshirë datën e administrimit)
- Riakutizime, data e episodeve
- BMI
- Plani i individualizuar i ndjekjes së SPOK-ut

**Plani i Individualizuar i Ndjekjes së SPOK-ut**, është një mjet i rëndësishëm në edukimin e pacientit për aftësimin e tij në vetëmenaxhimin e SPOK-ut.

Hartimi i planit dokumentohet në kartelë në ditën e hartimit dhe i jepet pacientit një kopje duke e sqaruar që ta sjellë çdo herë me vete në vizitë ose ta ketë me foto në celularin e tij.

2. Testin e vlerësimit të SPOK-ut (CATtest) dhe ka të dokumentuar të dhënat e përdorimit të tij në përshkrimin e ditës së vizitës përkatëse.

3. Programin e edukimit të pacientit me SPOK, ku dokumentohet data dhe çështjet e edukimit të pacientit dhe në përshkrimin e vizitës së asaj dite thuhet edukimi i pacientit për çështjen përkatëse.

\*Paketë-vite=paketë(a) cigareje të konsumuara në ditë e shumëzuar me vitet e duhanpirjes së rregullt.